



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 62/2 Prot

Tiranë, më 10.03.2022

V E N D I M

Nr. 38, datë 10.03.2022

Mbi përfundimin e hetimit administrativ me objekt kthimin në vendin e mëparshëm të punës, në përfundim të afatit 6-mujor të transferimit të përkohshëm të nëpunësës *** dhe veprimet që duhen kryer për rregullimin e gjendjes.**

Në mbështetje të kompetencave të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të nenit 90, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, mbi bazën e relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit të mbledhur në kuadër të verifikimit të çështjes,

Vërej se:

Nëpërmjet një kërkesë të paraqitur nga nëpunësja ***** , regjistruar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me nr. 62 prot., datë 17.1.2022, është ngritur pretendimi se, nga ana e Bashkisë Vau Dejës, nuk janë respektuar kërkesat e ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në lidhje me kthimin e saj në vendin e mëparshëm të punës, në përfundim të afatit maksimal 6-mujor, që parashikon ligji në rastet e transferimit të përkohshëm, prandaj ajo kërkon rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë.

Nga hetimi administrativ i këtij rasti, konstatohet se, nëpunësja ***** , ka kryer detyrën “Specialiste në Sektorin e Zyrës së Integruar me një Ndalesë”, në Njësinë Administrative Vau i Dejës. Me aktin nr. 236 (nr. 4376 prot.), datë 8.7.2021, të Kryetarit të Bashkisë Vau i Dejës, ajo është transferuar në pozicionin “Specialiste në Sektorin e Zyrës së Integruar me një Ndalesë”, në Njësinë Administrative Bushat.

Duke e konsideruar këtë emërim si një transferim të përkohshëm, nëpunësja në fjalë, i është drejtuar Komisionerit për kthimin e saj në vendin e mëparshëm të punës, për shkak të plotësisimit të afatit 6-mujor, që parashikon ligji në rastin e transferimeve të përkohshme, duke vënë në dijeni me këtë kërkesë edhe titullarin e institucionit.

Gjatë procesit të hetimit administrativ rezultoi se, institucioni ka reaguar duke ka rikthyer në detyrën e mëparshme nëpunësen ******, si “*Specialiste në Sektorin e Zyrës së Integruar me një Ndalesë*”, në Njësinë Administrative Vau i Dejës. Këtë fakt e bën me dije vetë kjo nëpunëse, e cila, nëpërmjet kërkesës në adresën elektronike zyrtare të KMSHC, datë 25.1.2022, drejtuar Komisionerit, ka kërkuar ndërprerjen e hetimit administrativ të nisur nga Komisioneri për këtë çështje, në kushtet kur ajo është sistemuar në vendin e mëparshëm të punës.

Në këto rrethana, kur kërkesat ligjore janë zbatuar në kohë nga ana e njësisë përgjegjëse, nuk ka më shkaqe për vazhdimin e hetimit administrativ, procesi i verifikimit ndërpritet dhe çështja arkivohet.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 90, të ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i RSH*”, si dhe në nenin 16, pika 6, të Rregullores, “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e hetimit administrativ mbi informacionin e marrë nga kërkesa e nëpunëses ******, me objekt kthimin në vendin e mëparshëm të punës në përfundim të afatit 6-mujor të transferimit të përkohshëm, pasi njësia përgjegjëse e ka kthyer nëpunësen në fjalë në vendin e mëparshëm të punës, dhe arkivimin e çështjes.
2. Të njoftohen për këtë vendim, Bashkia Vau-Dejës dhe nëpunësja ******.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha